



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M

K.P.P. 14/2019

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Enkeleda Bega	Nënkryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 11.01.2019 shqyrtoi ankesën me:

Objekt:

Modifikimi i dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit “Marrëveshje kuadër” me Nr.REF-95889-11-26-2018, me objekt: “Trajtimi dhe evadimi i mbetjeve të rrezikshme spitalore , në spitalin Librazhd e Prrenjas”, me fond limit 1.200.000 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 07.12.2018 nga autoriteti kontraktor Drejtoria e Sherbimit Spitalor Librazhd.

Ankimues:

“V.A.L.E Recycling” shpk
Fushë Kuqe, Gurrëz, afër ish – Kanalit të Acidit, Lezhë.

Autoriteti Kontraktor

Drejtoria e Sherbimit Spitalor Librazhd.
Rruga “Jahup Biçaku“ lagja Nr 2, Librazhd

Baza Ligjore:

Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim dhe pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V e r e n:

I


Vlerësimi paraprak

1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar;

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”;

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik;

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.



II

Rrethanat e çështjes.

II.1. Në datën 27.11.2018 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, procedura e prokurimit “*Marrëveshje kuadër*” me Nr.REF-95889-11-26-2018, me objekt: “*Trajtimi dhe evadimi i mbetjeve të rrezikshme spitalore , në spitalin Librazhd e Prrenjas*”, me fond limit 1.200.000 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 07.12.2018 nga autoriteti kontraktor Drejtoria e Sherbimit Spitalor Librazhd.

II.2. Në datën 03.12.2018, operatori ekonomik “V.A.L.E Recycling” sh.pk ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor, duke kërkuar modifikimin e dokumentave të procedurës së mësipërme të prokurimit me argumentat si më poshtë:

“Autoriteti Kontraktor Drejtoria e Sherbimit Spitalor Librazhd, (AK), ka njoftuar në SPE me datë 27.11.2018, hapjen e procedurave për realizimin e shërbimit “Trajtimi dhe evadimi i mbetjeve të rrezikshme spitalore, në spitalin Librazhd e Prrenjas” - Marrëveshje Kuader me një operator ekonomik - ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 1 vjeçar (12 muaj)” me fond limit me fond limit 1.200.000 lekë pa TVSH.

Në dokumentat e tenderit të publikuar, konstatojmë se disa nga kriteret për kualifikim janë hartuar në kundërshtim me LPP dhe RRPP, si dhe nuk janë në përputhje dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës.

A. Ne Dokumentat e Tenderit (DT), konkretisht ne shtojcën 10 dhe 11 është përcaktuar që shërbimi që kërkohet është sipas tabelës në vijim:

Nr	Emërtimi	Sasia në kg
1	<i>Te mprehta (age, ampula , drena bisturi, shishe qelqi, vigona)</i>	270
2	<i>Plastike(shiringa,aparate perfuzioni, shishe serumesh, tuba, katatere)</i>	2130
3	<i>Mbetje anatomike dhe radioaktive</i>	480
4	<i>Te tjera (garza, pambuk, leukoplast)</i>	120
	Totali	3000

Përcaktimi më sipër i Kodeve në shtojcën “Specifikimet teknike” është i pasaktë, pasi sipas kodit europian të mbetjeve por edhe sipas katalogut shqiptar të mbetjeve, të miratuar me VKM-në nr.99, datë 18.02.2005 “Për miratimin e katalogut shqiptar të klasifikimit të mbetjeve”, kategoritë e mbetjeve të kujdesit shëndetësor për njerëzit janë si vijon:

- 18 01 Mbetjet nga kujdesi shendetesor qe nga lindja, diagnostikimi, trajtimi dhe/ose parandalimi i semundjeve në njerezit.
- 18 01 01 Bisturite, shiringa, instrumente te mprehta (pervec 18 01 03).
- 18 01 02 Pjese te trupit dhe organe, perfshire qeset dhe konservuesit e gjakut dhe rezervat e gjakut (pervec 18 0103).
- 18 01 03 Mbetjet, grumbullimi dhe asgjesimi i te cilave kerkon trajtim te vecante per te parandaluar infeksionet.
- 18 01 04 Mbetjet, grumbullimi dhe asgjesimi i te cilave nuk kerkon trajtim te vecante per te parandaluar infeksionet (p.sh. veshje, hedhurinat e leukoplasteve, nderresat, veshje per te asgjesuar, pelena etj.)

Nga ana tjeter, ne pershkrimin e objektit te prokurimit, AK ka perfshire 2 grupime mbetjesh:

1. Mbetjet ne elementet 1, 2 dhe 4 te tabelës se dhene ne DT nga AK, qe perfshihen ne kategorite 18.01.01 dhe 18.01.04; dhe
2. Mbetjet ne elementet 3 te tabelës se dhene ne DT nga AK qe perfshihen ne kategorine 18.01.02.

Pra duket se kemi te bejme me mbetje qe perfshihen ne kategorine 18.01.02 dhe mbetje qe nuk perfshihen ne kategorine 18.01.02.

Neni 9, pika e VKM Nr.914, date 29.12.2014 “Per miratimin e rregullave te prokurimit publik” percakton se: “Kontrata ndahet ne lote, kur perbehet nga pune, mallra apo sherbime, homogjene ose te ngjashme, dhe kur vlera e kombinuar eshte e tille qe vetem nje numer i kufizuar operatorësh ekonomike do te ishin ne gjendje t'i siguronin ato. Kjo menyre mund te perdoret vecanerisht per te nxitur pjesemarrjen e biznesit te vogel e te mesem dhe per te ulur kostot administrative te autoritetit kontraktor.”

Aktualisht, nga te gjithë operatorët ekonomike te licensuar ne Republiken e Shqiperise per evadimin, administrimin, transportin, trajtimin e mbetjeve spitalore, vetem 3 prej tyre jane aktive (V.A.L.E Recycling, Eco Riciklim dhe MEDI-TEL), dhe nder keta te 3, vetem njeri eshte i licensuar aktualisht per kategorine 18.01.02 (MEDI-TEL).

Gjithashtu, sqarohet se ne VKM Nr.798, date 29.9.2010 “Per miratimin e rregullores per administrimin e mbetjeve spitalore”, Kreu II, percaktohet se:

“Detyrimet e prodhuesve të mbetjeve spitalore

5. Prodhuesit e mbetjeve spitalore jane pergjegjes per:

a) grumbullimin e kontrolluar te mbetjeve spitalore prane institucionit shendetesor;

b) ndarjen e mbetjeve spitalore te parrezikshme (te llojit urban) nga mbetjet spitalore te rrezikshme;

c) ambalazhimin, etiketimin, magazinimin, grumbullimin, trajtimin, transportimin dhe asgjesimin ne menyre te pershtatshme, te mbetjeve spitalore te gjeneruara prej tyre;

d) shpenzimet e transportit, asgjesimit ose riciklimit te mbetjeve spitalore te gjeneruara prej tyre.

Kjo pergjegjesi eshte e pashmangshme dhe e pavarur nga pergjegjesia e ndonje personi te trete te ngarkuar nga prodhuesi, per te ndermarre keto veprimtari;

e) te gjitha demet e shkaktuara ne menyre direkte ose indirekte ne mjedis dhe ne shendetin publik nga procesi i grumbullimit, magazinimit, transportimit dhe asgjesimit te mbetjeve spitalore te krijuara prej tyre”.

Ne rrethanat e mesiperme eshte e qarte se volumet takuese te elementeve te sherbimit te kerkuara nga AK, jane detyrim ligjor per prodhuesin, qe te jene te ndara ne burim, te ambalazhuar dhe te etiketuara, pra nuk ka asnje pengese qe te evidentohen dhe te maten si kategori te ndara te mbetjeve.

Ne kete menyre, duke qene se pothuaj 84 % e volumit te mbetjeve spitalore qe kerkohet te trajtohen nga AK, jane mbetje qe nuk perfshihen ne kategorine 18.01.02, mosndarja ne lote do penalizonte operatoret e tjere qe nuk jane te licensuar per kategorine 8.01.02 e cila ne volum eshte shume e vogel krahasuar me kategorite e tjera dhe do demtohej keshtu konkurenca.

Kuptohet kur ka konkurrence ka edhe reduktim te kostove per AK dhe ekonomicitet e efektivitet ne perdorimin e fondeve.

Per arsyet e mesiperme, kerkojme qe te ndryshohen Dokumentat e Tenderit dhe procedura te shpallet me Lote: Lot 1: Mbetje qe nuk perfshihen ne kategorine 18.01.02 dhe Loti 2: Mbetje qe perfshihen ne kategorine 18.01.02, me qellim nxitjen e konkurrences dhe mosdiskriminimin e operatoreve ekonomike.

B. Në Dokumentat e Tenderit, shtojca 7, pika 2.1 kërkohet:

“2.1.1. Operatori ekonomik duhet te disponoje licence per ushtrimin e aktivitetit lidhur me objektin e Kontrates, e leshuar nga QKB, me Kod: III.2.B dhe Leje kodi: III.1.C.

2.1.2. Operatori Ekonomik duhet te disponoje Akt-miratimi licence e kateqorise III.2.B dhe Leje Mjedisit e tipit A) leshuar nga Agjencia Kombetare e Mjedisit”.

Nuk jemi dakort me këtë kërkesë të Dokumentave të Tenderit për arsyet e mëposhtme:

Rezulton se AK, ka kerkuar qe OE te jene te pajisur me Leje Mjedisore III.1.C, ose e ashtuquajtur Leje Mjedisore e tipit A.

Ligji Nr. 10 448, date 14.07.2011 “Per Lejet e Mjedisit”, Shtojca 1 “Lejet e mjedisit te tipave A, B dhe C ne varesi te kapacitetit prodhues kufi”, ne kategorite 5.1 - 5.4 qe perfshijne operationet e asgjesimit te mbetjeve, parashikon qe e vetmja kategori qe pajiset vetem me Leje Mjedisore te tipit A, pavaresisht nga kapaciteti sasior, eshte kategoria 5.1.a “Incinerimi i mbetjeve te rrezikshme ne nje instalim incinerimi”. Metodat e tjera te asgjesimit, ne varesi te kapacitetit perpunues mund te kene edhe Leje Mjedisore te tipit B (III.1.B) ose te tipit C (III. 1.A). Pra rezulton se AK ka kushtezuar qe OE pjesemarrës te perdorin patjeter metoden e incenerimit per trajtimin e te gjitha mbetjeve te numeruar me elementet e sherbimit (1) - (4) ne tabelen e pergatitur nga AK per te ofertuar.

Ky lloj kushtezimi eshte ne kundërshtim me VKM Nr.798, date 29.9.2010, per miratimin e Rregullores "Per administrimin e mbetjeve spitalore".

Ne kete VKM, ne Kreun III, pika 8.10 percakton se: "Perpunimi dhe asgjesimi i mbetjeve spitalore kryhet me metodat sipas shtojces 3", ku ne Shtojcen 3 percaktohet: "Metoda për Trajtimin dhe Asgjesimin: 1. Incenerim, 2. Autoklavim: a) Presion, b) Presion - avull, c) Presion – avull - copetim. 3. Sterilizim me mikrovale 4. Sterilizim - UV 5. Trajtim kimik/dizinfektim: a) me shkumes te kloruar; b) me klor aktiv (klor te lire); c) me peroksid hidrogjeni (H2O2); d) me glutinimin e proteinave nepermjet perdorimit te acideve; e) me ozon (O3)".

Pra, VKM nuk ben dallime ndërmjet metodave te perdorshme per rryma te caktuara mbetjesh spitalore dhe nuk percakton ndonje metode te detyrueshme ne raport me te tjerat. Per me teper, per sa kohe organet shteterore te ngarkuara me licencimin jane Ministria e Mjedisit dhe Agjencite e mjedisit, jane ato qe gjate procesit te licensimit percaktojne per operatore te vecante llojin e licenses dhe metodat e lejuara per kategori te caktuara mbetjesh, pra nuk eshte AK autoriteti qe gjykon nese duhet kerkuar nje metode e caktuar apo jo, pasi kjo do te ishte diskriminuese dhe do krijonte pabarazi ndërmjet operatoreve.

Nga ana tjeter sa i perket specifikisht mbetjeve anatomike, Udhezuesi Kombetar i Administrimit te sigurte te mbetjeve spitalore, pika 2.1.3. percakton se: "2.1.3 Indet e njerezore. Kjo kategori perfshin mostrat patologjike, mostrat e biopsise dhe inde te marra gjate operacionit ose autopsise. Kjo nuk perfshin kufomat, per te cilat ka kerkesa te vecanta rregullatore per asgjesimin. Indet njerezore perfshijne indet, organet, gjymtyret, gjakun e rrjedhshem apo te shprehshem dhe lengjeve te tjera trupore qe jane larguar gjate operacionit, lindjes dhe autopsise dhe perjashtojne dhembet, floket, thonjte, urinen dhe fecen. Nuk perfshihen gjithashtu, pecetat higjienike, tamponet dhe pelenat, duke qene se ato jane pjese e rrymes se mbetjeve te pergjithshme. Fetuset qe rezultojne nga procedurat mjekesore, pavaresisht nga pamja dhe indet trupore vizualisht te dallueshme, te tilla si gjymtyret, nuk kane nevoje per varrim ligjor. Ato duhet te paketohen ne menyre te vecante, te etiketohen dhe asgjesohen me incenerim te miratuar dhe nen mbikeqyrje. Administrimi dhe asgjesimi i llojeve te caktuara te mbetjeve patologjike duhet te kryhet duke patur parasysh reagimet e publikut dhe konsideratat estetike. Organet e trupit, gjymtyret, placentat dhe fetuset mund te mos paraqesin ndonje rrezik per personat qe merren me to apo per komunitetin, por administrimi jo i duhur gjate trajtimit dhe asgjesimit mund te shkaktojte shqetesim te panevojshem publik. Incenerimi eshte metode e preferuar trajtimi per kategorine e mbetjeve: indeve njerezore, ne vecanti per pjeset anatomike te dallueshme. (Duhet patur parasysh se incenerimi nuk eshte i pershtatshem per dhembet qe permbajne mbushje me amalgam duke qene se shkarkimet nga merkuri jane shume te rrezikshme)".

Sqarojme se Udhezuesi ne piken e mesiperme, nuk shpreh detyrimin qe kjo katogeri mbetjesh te trajtohen me metoden e incenerimit, po cileson qe kjo metode eshte "e preferuar", pra nuk i perjashton metodat e tjera per sa kohe subjektet jane te licencuara rregullisht per keto metoda te tjera. Kjo nuk e ve AK para detyrimit qe ta perzgjedhe kete metode, por eshte thjesht rekomanduese, pasi edhe VKM-ja nuk percakton detyrime per ndonje metode te caktuar. Pra, AK duke synuar te rrise sa me shume pjesemarrjen dhe konkurrencen, ne perputhje dhe me nenet 1 dhe 2 te LPP dhe me Nr.798, date 29.9.2010, nuk i perjashton metodat e tjera, per sa kohe konkurentet do te provojne se jane te licencuar rregullisht per kategorite e mbetjeve dhe per keto metoda te tjera. Kujtojme ketu se AK ka shtuar tek mbetjet anatomike

edhe mbetjet radioaktive, por Udhezuesi percakton rregulla te vecanta per trajtimin e mbetjeve radioaktive, qe nuk e parashikojne incenerimin.

Nga ana tjeter, per sa kohe keto sasi te mbetjeve anatomike jane shume te vogla ne raport me rrymat e tjera te mbetjeve, nuk mund te diskriminohen nje numer operatoresh te tjere, duke u vendosur kriteret perjashtuese, dhe ne kete menyre do mbetjet ne gare vetem 1 operator qe do ndikonte pastaj duke rritur cmimin ne total per te gjitha rrymat e mbetjeve ne menyre te paarsyeshme.

Bashkelidhur tabela permbledhese e Udhezuesit Kombetar i Administrimit te sigurte te mbetjeve spitalore per metodat e trajtimit te rrymave te ndryshme te mbetjeve spitalore.

Ne konkluzion kerkojme qe pika 2.1 te kapaciteti ligjor ne Dokumentet Standarte te Tenderit te behet: "2.1 Kapaciteti ligjor i operatoreve ekonomike:

1. Operatori ekonomik duhet te disponoje licence per ushtrimin e aktivitetit lidhur me objektin e Kontrates, e leshuar nga QKB, me Kod: III.2.B dhe Leje Mjedisore me kodin: III.1.C ose III.1.B ose III.1.A.

2. Operatori ekonomik duhet te disponoje Akt-miratimi (licence e kategorise III.2.B dhe Leje Mjedisore e tipit A, B, ose C) leshuar nga Agjencia Kombetare e Mjedisit".

3. Ne Shtojcen 7, pika 2.3.4 kerkojme:

"5. Operatori duhet te disponoje impiant per asgjесimin e seciles kategori te prokuruar nga Autoriteti yne Kontraktor te mbetjeve spitalore, anatomike dhe radioaktive sipas Ligjit Nr. 10463, date 22.09.2011 "Per menaxhimin e integruar te mbetjeve", si dhe te VKM Nr. 798, date 29.9.2010, per miratimin e rregullores "Per administrimin e mbetjeve spitalore" (Rregullorja).

Per kete operatori ekonomik duhet te paraqesi te markuar:

- katalog te impiantit perkates, ku perfshihen edhe specifikimet teknike te hollesishme, per secilen procedure asgjесimi, te kerkuar nga Autoriteti yne Kontraktor. Kataloget do te pranohen vetem ne forme elektronike nepermjet Sistemit Elektronik".

Gjithashtu ne shtojcen 8 percaktohet: "1. Mbetjet e rrezikshme spitalore dhe anatomike duhet te asgjесohen nen nje impiant per incinerim i cili eshte i licensuar nga Ministria e Mjedisit per kryerjen e ketij sherbimi...".

Edhe keto pika i kundershtojme, te lidhur me kundershkrimin e parashtruar ne (1) me siper, pasi edhe ne kete rast vete AK, duke mos e ndare ne lote proceduren, ka diskriminuar operatoret qe kane licence dhe impiante per trajtimin e rrymave te mbetjeve, te perfshire ne elementet (1), (2) dhe (4) te tabelave se sherbimeve te kerkuara, por qe nuk kane vetem impiant incinerimi per mbetjet ne elementin (3), duke i diskriminuar keta OE dhe duke favorizuar OE MEDI-TEL, qe eshte i vetmi OE qe aktualisht ka nje impiant te tille.

4. Ne shtojcen 7, pika 2.3.2 kerkojme:

"Kerkojme qe ofertuesi te paraqese nje vertetim per fuqine punetore te operatorit ekonomik per periudhen janar-tetor 2018), numri i te cilëve te jetë jo më pak se 3 punonjës të nevojshëm për realizimin e objektit të prokurimit, ndër të cilët njëri nga punonjësit duhet të jetë inxhinjer mjedisi, me qëllim realizimin me sukses të këtij Shërbimi.

Për këtë, Operatori Ekonomik duhet të paraqesë:

2 Vertetim të lëshuar nga Zyra e tatim-taksave së bashku me listëpagesat sipas formularit E-SIG 025, ku te pasqyrohen minimumi tre punonjës;

3 Liste te personelit kryesor te nevojshem per realizimin e ketij sherbimi.

4 Per inxhinjerin e mjedisit duhet te paraqitet:

a. Kopja e diplomes së Universitetit;

b. Vërtetim nga Tatimet ku të figurojë tek listëpagesat sipas formularit E-SIG 025 si dhe Kontratë Pune, e lidhur me inxhinjerin e mjedisit. ”

Për autoritetin kontraktor është e nevojshme dhe e mjaftueshme që operatorët ekonomikë të plotësojnë të gjitha kapacitetet ekonomike, teknike, profesionale për realizimin me sukses të kontratës, duke evituar kushte kufizuese. Në rastin konkret kërkesa që OE të kenë pasur të punësuar në listpagesa gjatë gjithë periudhës janar-tetor 2018 një inxhinier mjedisi, është një kriter që nuk i shërbën qëllimit për realizimin me sukses të kontratës, por krijon efektin e kufizimit për pjesëmarrjen e gjërë të operatorëve ekonomikë. Ajo që është e rëndësishme për AK është që OE të ketë në dispozicion për zbatimin e kontratës dhe kjo mund të realizohet, duke u provuar një marrëdhënie e qëndrueshme e OE me inxhinier mjedisi, qoftë në formën e kontratës së punës apo kontratës së shërbimit, për një periudhë të arsyeshme dhe jo domosdoshmërisht përgjatë të gjithë periudhës janar-tetor 2018. Mund të ndodhë që OE të ketë patur në periudha të ndryshme të punësuar ose të angazhuar me kontratë shërbimi inxhinierë mjedisi të ndryshëm, por e rëndësishme për AK është që OE, në momentin e lidhjes eventuale të kontratës, të ketë një inxhinier të tillë, pavarësisht nga historiku i punësimit të këtij inxhinieri në AK. [...].

Në konkluzion: Kërkojmë që të modifikohet në dokumentat e tenderit kjo kërkesë dhe të bëhet:

“Kërkohet që ofertuesi të paraqesë një vërtetim për fuqinë punëtore të operatorit ekonomik për periudhën janar-tetor 2018), numri i të cilëve të jetë jo më pak se 3 punonjës të nevojshëm për realizimin e objektit të prokurimit.

OE duhet të ketë në dispozicion një inxhinier mjedisi, me qëllim realizimin me sukses të këtij Shërbimi. Për këtë, Operatori Ekonomik duhet të paraqesë:

1. Vërtetim të lëshuar nga Zyra e tatim-taksave së bashku me listëpagesat sipas formularit E-SIG 025, ku te pasqyrohen minimumi tre punonjës;

2. Liste te personelit kryesor te nevojshem per realizimin e ketij sherbimi.

3. Per inxhinjerin e mjedisit duhet te paraqitet:

a. Kopja e diplomes së Universitetit;

b. Kontrata e punes ose e shërbimit. ”

II.3. Nëpërmjet shkresës nr. 87/11 prot., datë 04.12.2018, të autoritetit kontraktor, operatori ekonomik “V.A.L.E Recycling” shpk, është vënë në dijeni në lidhje me mospranimin e ankesës së paraqitur prej tij.

II.4. Në datën 14.12.2018, pala ankimuese operatori ekonomik “V.A.L.E Recycling” shpk, ka dorëzuar ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, me të njëjtin objekt ankese dorëzuar pranë autoritetit kontraktor.

II.5. Me shkresën me nr. 87/15 prot, datë 24.12.2018, protokolluar me tonën me nr. 1883/2 prot, datë 26.12.2018, me objekt “Dërgojmë informacion për prokurimin me objekt “Trajtimi dhe evadimi i mbetjeve të rrezikshme spitalore, në spitalin Librazhd e Prrenjas” është depozituar në Komisionin e

Prokurimit Publik informacioni dhe dokumentacioni i autoritetit kontraktor lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit për trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, si edhe informacionit dhe dokumentacionit të autoritetit kontraktor

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “V.A.L.E Recycling” shpk në lidhje me “ndryshimin e Dokumentave të Tenderit dhe procedura te shpallet me Lote: Lot 1: Mbetje qe nuk perfshihen ne kategorine 18.01.02 dhe Lot 2: Mbetje qe perfshihen ne kategorine 18.01.02, me qellim nxitjen e konkureses dhe mosdiskriminimin e operatoreve ekonomike”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.1.1. Në shtojcën 10 “Shërbimet dhe grafiku i ekzekutimit” dhe shtojcën 11 “Termet e referencës” të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt ankimi është parashikuar se:

Shërbimi që kërkohet:

“Evadim i mbetjeve të rrezikshme spitalore dhe anatomike, ”- Marrëveshje Kuadër me një operator ekonomik - ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat (12 muaj)”.

Nr.	Emertimi	Sasia ne kg
1	Te mprehta(age, ampula, drena, bisturi, shishe qelqi, vigona)	270
2	Plastike (shiringa, aparate perfuzioni, shishe serumesh, tuba, katetere)	2130
3	Mbetje anatomike dhe radiologjike	480
4	Te tjera(garza, pambuk, lekoplast)	120
	Totali	3000

6. Kohëzgjatja e kontratës ose afati kohor për ekzekutimin 12 muaj nga data e nënshkrimit të marrëveshjes kuadër.

III.1.2. Në shtojcën 8 “Specifikimet Teknike”, të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt ankimi është parashikuar se:

1. Mbetjet e rrezikshme spitalore dhe anatomike duhet të asgjësohen ne një impiant për inçinerim i cili është i licensuar nga Ministria e Mjedisit per kryerjen e këtij shërbimi, terheqja e mbetjeve do te behet sipas nevojave te Autoritetit Kontraktor.

2. Operatori ekonomik duhet te instaloje nga nje frigoriferi ne ambientet e Spitalit Librazhd e Prrenjas ” me kapacitet 200 - 250 L dhe temperature - 18 C per ruajtjen e mbetjeve te rrezikshme spitalore anatomike te lengshme dhe te ngurta deri ne momentin e transportimit per ne impiantin e asgjesisimit. Pas marrjes se mbetjeve operatori do te beje dezenfektimin e frigoriferit dhe ambientit perreth , si dhe mirembaje frigoriferin.

3. Te sigurohet dizinfektimi i mire i frigoriferit dhe ambientit ku eshte instaluar.
4. Mbetjet duhet te merren nga sipermarresi prane Drejtorise se Spitalit Librazhd dhe Prrenjas me mjet te posacem te sipermarresit dhe me abalazhimin perkates ne perputhje me standartet e OBSH, per mbetjet e rrezikshme spitalore anatomike te ngurta dhe te lengshme duke respektuar standartin sipas VKM 798, dt.29.09.2010, “ Per administrimin e mbetjeve spitalore “.
5. “Asgjesimi duhet te realizohet në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.798, datë 29.9.2010, për miratimin e rregullores “Për administrimin e mbetjeve spitalore” (Rregullorja), si dhe Udhëzuesit Kombëtar të Administrimit të sigurtë të mbetjeve spitalore.”.
6. Mbetjet do te peshohen ne pranine e perfaqesuesve te te dyja paleve nga një peshore, e cila duhet të disponohet nga Operatori Ekonomik.
7. Qeskat dhe kontenierët duhet të mbulohen nga sipermarresi dhe duhet të jenë me një përdorim. Kontenieret,qeskat qe perdoren per grumbullimin e mbetjeve te rrezikshme spitalore qe trajtohen ne hidrokлавin e spitalit te sigurohen nga operatori fitues.Kontenieret duhet te jene me kapacitet nga 5 L , 40 L dhe 60 L. Kontenieret dhe qeskat duhet te jene me ngjyre te verdhe dhe logon e firmes fituese . Te gjithë kontenieret qe perdoren nga spitali duhet te merren nga firma dhe te behet dezinfektimi i tyre prej saj. Amballazhi duhet te jete sipas percaktimeve te bera ne VKM 798, dt.29.09.2010 “Per administrimin e mbetjeve spitalore“, si dhe Udhëzuesit kombëtar “Administrimi i Sigurtë i mbetjeve Spitalore”.
8. Autoriteti Kontraktor do të kontrollojë pas hapjes së ofertave impiantin që disponon firma për t’u siguruar për standartin dhe cilësinë e tij.
9. Operatori Ekonomik duhet të pajisi A.K. me sinjalistikë dhe tabela sinjalizuese të cilat tregojnë prezencën e mbetjeve të rrezikshme në ambientin/ambjentet përkatëse të Autoritetit kontraktor, në bazë të VKM Nr. 798, datë 29.09.2010 dhe Udhëzuesit kombëtar “Administrimi i Sigurtë i mbetjeve Spitalore”.
10. Terheqja e mbetjeve te rrezikshme spitalore do te behet cdo jave ose ne varesi te kerkeses se autoritetit kontraktor.
11. Operatori ekonomik dhe Perfaqesuesit e Spitalit per cdo dorezim mbetjesh spitalore tek operatori per asgjesim do te mbajne “Dokumentin e dorezimit te mbetjeve te Rrezikshme” sipas VKM Nr. 371 date 11.06.2014 “Per miratimin e rregullave per dorezimin e mbetjeve te rrezikshme dhe te dokumentit te dorezimit te tyre”
12. Mbetjet e vendosura në ambalazh do të peshohen në praninë e përfaqësuesve të të dy palëve, hartohet proces verbali për sasinë e peshuar në tre kopje dhe nënshkruhet nga sipërmarrësi dhe përfaqësuesi i autoritetit kontraktor. Dy kopje mbeten në DSHS Librazhd dhe një kopje e merr sipërmarrësit.
13. Pesha e mbeturinave të rrezikshme spitalore do të llogaritet neto duke zbritur peshën e ambalazhit.
14. Tek formulari i transferimit te mbetjeve te rrezikshme spitalore te shenohen dhe kodet perkatese per cdo lloj mbetje:
 - Anatomiket KODI 18 01 02
 - Te mprehtat KODI 18 01 01
 - Te butat, plastiket KODI 18 01 03.

III.1.3. Referuar Ligjit Nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, neni, pika 2 prashikohet shprehimisht se:

“Qëllimi i këtij ligji është:

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik, të kryera nga autoritetet kontraktore;
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik
- d) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;
- e) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;”

III.1.4. Në kreun II, Neni 9, pika 5 e të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Rregullat e Prokurimit Publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht:

“Kontrata ndahet në LOTE, kur përbëhet nga punë, mallra apo shërbime, homogjene ose të ngjashme, dhe kur vlera e kombinuar është e tillë që vetëm një numër i vogël operatorësh ekonomikë do të ishin në gjendje t’i siguronin ato. Kjo mënyrë mund të përdoret veçanërisht për të nxitur pjesëmarrjen e biznesit, të vogël e të mesëm, apo për të ulur kostot administrative të autoritetit kontraktor.”

III.1.5. Në Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 798, datë 29.09.2010 “Për miratimin e rregullores për administrimin e mbetjeve spitalore”, në Kreun I, pika 1 dhe 2 Qëllimi dhe Objekti, parashikohet shprehimisht:

“Kjo rregullore përcakton procedurat, rregullat dhe standardet teknike për administrimin e mbetjeve spitalore me qëllim mbrojtjen e shëndetit publik dhe të mjedisit”.

- a) “Mbetje spitalore” janë mbetjet e krijuara nga prodhuesit e mbetjeve, ku përfshihen: mbetjet e rrezikshme dhe jo të rrezikshme, të cilat renditen në paragrafin 18 të vendimit nr.99, datë 18.2.2005 të vendimit të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e Katalogut Shqiptar të Klasifikimit të Mbetjeve”.
- k) “Mbetje e rrezikshme” përfshijnë mbeturinat e infektuara, patologjike, shpuese, farmaceutike, toksike, kimike dhe radioaktive, ujin dhe tretës të infektuar”

III.1.6. Në Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 798, datë 29.09.2010 “Për miratimin e rregullores për administrimin e mbetjeve spitalore”, në Kreun IV, “Leja Mjedisore dhe Akt Miratimi Higjeno – Sanitar”, parashikohet shprehimisht:

10.1. Grumbullimi, transportimi, përpunimi dhe asgjësimi i mbetjeve spitalore kryhen nga organet kompetente shtetërore, personat juridikë publikë, si dhe personat fizikë apo juridikë privatë, që janë pajisur me lejen përkatëse për ushtrimin e kësaj veprimtarie.

10.2. Leja e veprimtarisë së mësipërme është e vlefshme në shkallë vendi dhe miratohet nga Ministri i Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave.

10.3. Inspektorati Sanitar Shtetëror, pas ekspertimit higjieno-shëndetësor, lëshon aktmiratim higjieno-sanitar për ushtrimin e veprimtarisë.

III.1.7. Nga shqyrtimi i dokumentave të tenderit vihet re se kjo procedurë ka për qëllim asgjësimin e mbetjeve të rrezikshme spitalore, në spitalin Librazhd e Prrrenjas, mbetje të cilët janë si bisturitë, shiringa, instrumente të mprehta me kod 18 01 01; Pjesë të trupit dhe organe, përfshirë qeset dhe konservuesit e gjakut dhe rezervat e gjakut (përveç 18 01 03), me kod 18 01 02; Mbetjet, grumbullimi dhe asgjësimi i të cilave kërkon trajtim të veçantë për të parandaluar infeksionet me kod 18 01 03; dhe Mbetjet,

grumbullimi dhe asgjësimi i të cilave nuk kërkon trajtim të veçantë për të parandaluar infeksionet (p.sh. veshje, hedhurinat e leukoplasteve, ndërresat, veshje për të asgjësuar, pelena etj.) me kod 18 01 04 anatomike, të mprehta dhe mbetje të buta, plastike, të cilat referuar VKM nr. 798, datë 29.09.2010 “*Për miratimin e rregullores për administrimin e mbetjeve spitalore*” dhe konkretisht në Kreun I, pika 1 dhe 2 gërma (k), rezulton se bëjnë pjesë tek mbetjet e rrezikshme të cilat duan metoda dhe trajtime të veçanta për asgjësim e tyre po ti referohemi shtojcës 3 të kësaj VKM.

Komisioni i Prokurimit Publik thekson se ndarja ose jo, e kontratës në lote, është një vendim i rëndësishëm që autoriteti kontraktor merr gjatë procesit paraprak të prokurimit (hartimit të kriterëve kualifikuese nga njësia e prokurimit), pasi ndikon drejtperdrejt në nivelin e pjesmarrjes së operatorëve ekonomike në këtë procedurë prokurimi. Kjo bëhet duke mbajtur në konsideratë elemente të tilla si: tregu, konkurrenca e mundshme, vlera e prokurimit, etj., dhe veçanërisht faktin nëse objekti i kontratës është një punë/shërbim/mall për të cilin ofertuesit janë të pakët, pra, gëzojnë në një farë mënyre të drejtën e prodhimit, apo distribucionit.

III.1.8. Komisioni nuk e gjykon të drejtë pretendimin e ankimuesit lidhur me ndarjen me lote të procedurës pasi, referuar VKM nr. 798, datë 29.09.2010 “*Për miratimin e rregullores për administrimin e mbetjeve spitalore*” vëren se në Kreun I, pika 1 dhe 2 gërma (k) thuhet se: “*Mbetje të rrezikshme përfshijnë mbeturinat e infektuara, patologjike, shpuese, farmaceutike, toksike, kimike dhe radioactive dhe tretës të infektuar*”, nisur nga sa më sipër si dhe referuar grafikut për ekzekutimin, rezulton se mbetjet e përcaktuara nga autoriteti kontraktor për asgjësim në këtë procedurë prokurimi bëjnë pjesë tek mbetjet e rrezikshme të parashikuara në VKM e sa më sipër cituar, dhe ndarja në Lote e procedurës së prokurimit sipas pretendimit të ankimuesit Lot më vetë për mbetjet që nuk përfshihen në kategorinë 18 01 02 dhe Lot më vetë për mbetjet që përfshihen në kategorinë 18 01 02, do të komplikonte menaxhimin e kontratave dhe shpërndarjen e përgjegjësi duke e komplikuar edhe realizimin me sukses të kontratës. Komisioni gjykon se autoriteti kontraktor ka vepruar drejt dhe në përputhje me frymën e legjislacionit të sipërpërmendur.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “*V.A.L.E Recycling*” nuk qëndron.

III.2. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “*V.A.L.E Recycling*” sh.p.k për ndryshimin e kriterit: **1.** “*Operatori ekonomik duhet të disponojë licence për ushtrimin e aktivitetit lidhur me objektin e Kontrates, e lëshuar nga QKB, me Kod: III.2.B dhe Leje Mjedisore me kodin: III.1.C ose III.1.B ose III.1.A. dhe 2. Operatori ekonomik duhet të disponojë Akt-miratimi (licence e kategorise III.2.B dhe Leje Mjedisi e tipit A, B, ose C) lëshuar nga Agjencia Kombeiare e Mjedisit*”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.2.1. Në shtojcën 7/2 “*Kriteret e veçanta të kualifikimit*”, pika 2.1 “*Kapaciteti ligjor i operatorëve ekonomik*” në dokumentat standarte të procedurës së prokurimit objekt ankimi është parashikuar se:

- *Operatori ekonomik duhet të disponojë Liçencë për ushtrimin e aktivitetit lidhur me objektin e Kontratës, e lëshuar nga QKB, me Kod: III.2.B dhe Leje kodi: III.1.C.*
- *Operatori Ekonomik duhet të disponojë Akt-miratimi (liçencë e kategorisë III.2.B dhe Leje Mjedisi e tipit A) lëshuar nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit.*

III.2.2. Në nenin 46 pika 1 gërma “a” dhe gërma “b” e ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar parashikohet se: “[...] Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese: a) kualifikimi profesional: çdo operatori ekonomik i kërkon licencat profesionale, industriale apo tregtare, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore, për veprimtaritë e kërkuara dhe për të cilat do të lidhet kontrata;

III.2.3. Në nenin 46, pika 2 e ligjit nr.9643 dt.20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet se : “ [...] Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese: 2. Autoriteti kontraktor mund të kërkojë edhe certifikata, të lëshuara nga organe të pavarura, që vërtetojnë pajtueshmërinë e kandidatit ose të ofertuesit me standardet e kërkuara të cilësisë, përfshirë edhe standardet për menaxhimin e mjedisit. [...]”

Ndërsa në nenin 53, pika 3 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, përcakohet se: “Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një oferte të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit....”

III.2.4. Në nenin 28 pika 5 gërma “a” të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Rregullat e Prokurimit Publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht:

5. Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti kontraktor kërkon: a) licencat profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose.

III.2.5. Në Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 798, datë 29.09.2010 “Për miratimin e rregullores për administrimin e mbetjeve spitalore”, në Kreun IV, “Leja Mjedisore dhe Akt Miratimi Higjieno – Sanitar”, parashikohet shprehimisht:

10.1. Grumbullimi, transportimi, përpunimi dhe asgjësimi i mbetjeve spitalore kryhen nga organet kompetente shtetërore, personat juridikë publikë, si dhe personat fizikë apo juridikë privatë, që janë pajisur me lejen përkatëse për ushtrimin e kësaj veprimtarie.

10.2. Leja e veprimtarisë së mësipërme është e vlefshme në shkallë vendi dhe miratohet nga Ministri i Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave.

10.3. Inspektorati Sanitar Shtetëror, pas ekspertimit higjieno-shëndetësor, lëshon aktmiratim higjieno-sanitar për ushtrimin e veprimtarisë.

III.2.6. Në Ligjin Nr 10448, datë 14.07.2011, “Për Lejet e Mjedisit”, në nenin 1 dhe 2 “Qëllimi dhe Objekti”, parashikohet shprehimisht:

“Ky ligj ka për qëllim parandalimin, pakësimin dhe mbajtjen nën kontroll të ndotjes së shkaktuar nga disa kategori veprimtarish, në mënyrë që të arrihet një nivel i lartë i mbrojtjes së mjedisit në tërësi, shëndetit të njeriut dhe cilësisë së jetës”.

Ky ligj përcakton:

a) rregullat për lejimin e zhvillimit të disa veprimtarive që shkaktojnë ndotje të mjedisit në Republikën e Shqipërisë;

b) masat e parashikuara për parandalimin e kësaj ndotjeje dhe, kur kjo nuk është e mundur, masat për pakësimin e shkarkimeve të tyre të gazta, të lëngëta e të ngurta në ajër, ujë e tokë.

III.2.7. Në neni 4 “Sistemi i lejeve të mjedisit” të Ligjin Nr 10448, datë 14.07.2011, “Për Lejet e Mjedisit”, parashikohet shprehimisht:

1. Në përputhje me ligjin nr. 10431, datë 9.6.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”, krijohet një sistem prej tri nivelesh të lejeve të mjedisit, të tipit A, B e C, si më poshtë:

a) leja e mjedisit e tipit A është e detyrueshme për kryerjen e veprimtarive të kategorisë A, lista dhe pragjet përkatëse të të cilave janë përcaktuar në shtojcën I/A të këtij ligji;

b) leja e mjedisit e tipit B është e detyrueshme për kryerjen e veprimtarive të kategorisë B, lista dhe pragjet përkatëse të të cilave janë përcaktuar në shtojcën I/B të këtij ligji;

c) leja e mjedisit e tipit C është e detyrueshme për kryerjen e veprimtarive të kategorisë C, lista dhe pragjet përkatëse të të cilave janë përcaktuar në shtojcën I/C të këtij ligji.

III.2.8. Në shtojcën 1 “Lejet e mjedisit të tipave A, B dhe C në varësi të kapacitetit prodhues kufi” të Ligjin Nr 10448, datë 14.07.2011, “Për Lejet e Mjedisit”, parashikohet shprehimisht:

“Kur një operator kryen veprimtari të ndryshme nën të njëjtin nëntitull si më poshtë dhe nën të njëjtin nëntitull si më poshtë dhe në të njëjtin instalim ose në të njëjtën vendndodhje, kapacitetet e këtyre veprimtarive mbledhen bashkë. Nqs nuk përcaktohet ndryshe, në tabelën e mëposhtme, kapaciteti **kufi** nënkupton kapacitetin e plotë prodhues të asaj veprimtarie, pavarësisht nga fakti nëse ai shfrytëzohet plotësisht apo jo.

	ID	Veprimtaria	Kapaciteti kufi për lejet e Tipit A	Kapaciteti kufi për lejet e Tipit B	Kapaciteti kufi për lejet e Tipit C
Industritë energjetike	5.1	a. Incinerimi i mbetjeve të rezikshme në një instalim incinerimi	Të gjitha instalimet	-----	-----

III.2.9. Komisioni i Prokurimit Publik, nisur nga sa më lart, vlerëson se kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Bazuar në ligjin dhe rregullat e prokurimit publik, si dhe në ligjin specifik për asaj të përkatë rastit konkret është në të drejtën e autoritetit kontraktor të përcaktojë kriteret për kualifikim, në përputhje me dispozitat ligjore gjithnjë kur ato janë të nevojshme dhe të lidhura ngushtë me objektin e prokurimit, bazuar në legjislacionin për prokurimin publik duke mos i tejkaluar kufijtë maksimalë të përcaktuar në këtë të fundit, në funksion të qëllimit dhe parimeve të ligjit për prokurimin publik. Refruar sa më sipër, Komisioni gjykon se kriteri i përcaktuar nga autoriteti kontraktor lidhur me “Liçencë me Kod III.2.B dhe Kod III.1.C, si dhe Leje Mjedisi e tipit A”, është në përputhje

dhe i lidhur ngushtë me objektin e kontratës si dhe në përputhje me dispozitat ligjore si të Ligjit Nr 10448, datë 14.07.2011, “Për Lejet e Mjedisit”, ashtu dhe të VKM Nr. 798, datë 29.09.2010 “Për miratimin e rregullores për administrimin e mbetjeve spitalore”, të më sipërcituara. Komisioni i Prokurimit Publik, nisur nga sa më lart, vlerëson se Autoriteti kontraktor harton dokumentat e tenderit, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi ndaj dhe përcaktimi i kriterëve të veçanta për kualifikim është lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktues, gjithnjë në përputhje e përpjesëtim me objektin e natyrën e kontratës së prokurimit.

Komisioni gjykon se autoriteti kontraktor me anë të kërkesës së tij për disponueshmërinë e “Liçencës me Kod III.2.B dhe Kod III.1.C, si dhe Lejes Mjedisore e tipit A” me objektin e kontratës së prokurimit nuk ka kufizuar konkurrencën pasi një kriter i tillë nuk është diskriminues për operatorët ekonomikë, pasi dispozitat ligjore të mësipërcituara referuar ligjit për “Lejet Mjedisore” nuk vendosin kufizime në lidhje me aplikimin dhe pajisjen e operatorëve ekonomik të cilët plotësojnë kushtet dhe kriteret për Licencat dhe Lejet e mësipërcituara.

Autoriteti kontraktor në dokumentacionin e sjellë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në procesverbalin e hartimit të dokumentave të tenderit, sqaron se kërkesa për çertifikimin e impiantit është përcaktuar si kusht i domosdoshëm duke patur parasysh specifikimin e kësaj pajisje e cila sjell ndotjen e mjedisit dhe në këto kushte çertifikimi i saj nga Ministria e Mjedisit është i domosdoshëm. Referuar sa më lart, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se në rastin konkret kemi të bëjmë me trajtim të mbeturinave/mbetjeve spitalore të cilat rrjedhimisht kanë edhe ndikimin apo impaktin e tyre në mjedis. Autoriteti kontraktor ka argumentuar se pajisja apo impianti që do të bëjë përpunimin e mbetjeve duhet të jetë i pajisur me dokumentacionin përkatës të lëshuar nga Ministria e Mjedisit. Ushtrimi i veprimtarisë së trajtimit të mbetjeve spitalore në lidhje me impiantin ku ushtrohet ky aktivitet pajiset me leje mjedisore që lëshohet nga Ministria e Mjedisit, kërkesë kjo e përcaktuar nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit, dhe fakt që pranohet edhe nga vetë ankimesi. Në këtë rast kërkesa e autoritetit kontraktor për pajisjen me dokumentacionin e duhur lëshuar nga Ministria e Mjedisit për veprimtarinë në fushën e trajtimit të mbetjeve është në përpjesëtim me kontratën objekt prokurimi.

Për rrjedhojë pretendimi i operatorit ekonomik ankimes nuk qëndron.

III.3. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimes “V.A.L.E Recycling” shpk për modifikimin e kriterit të vecantë të kualifikimit me argumentat se “Operatori duhet të disponojë impiant për asgjësimin e seciles kategori të prokuruar nga Autoriteti yne Kontraktor të mbetjeve spitalore, anatomike dhe radioaktive sipas Ligjit Nr. 10463, date 22.09.2011 “Per menaxhimin e integruar të mbetjeve”, si dhe të VKM Nr. 798, date 29.9.2010, për miratimin e rregullores “Per administrimin e mbetjeve spitalore” (Rregullorja). Per kete operatori ekonomik duhet të paraqesi të markuar: - katalog të impiantit perkates, ku perfshihen edhe specifikimet teknike të hollesishme, për secilen procedure asgjësimi të kerkuar nga Autoriteti yne Kontraktor. Kataloget do të pranohen vetem në forme elektronike nepermjet Sistemit Elektronik. Edhe kete pike e kundërshtojme të lidhur me kundërshtimin e parashtruar në (A) me sipër, pasi edhe në këtë rast vete AK, duke mos e ndare në lote proceduren, ka diskriminuar operatorët që kanë licenca dhe impiante për trajtimin e rrymave të mbetjeve të perfshire në elementet (1), (2) dhe (4) të tabelës së shërbimeve të kerkuara, por që nuk kanë vetem impiant incenerimi për mbetjet në elementin (3), duke i diskriminuar këta OE”., Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.3.1. Në shtojcën 7/2 “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, pika 2.3.4 “kapaciteti teknik dhe profesional” të dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet si më poshtë:

“Operatori duhet të disponojë impiant për asgjësimin e secilës kategori të prokuruar nga Autoriteti ynë Kontraktor të mbetjeve spitalore, anatomike dhe radioaktive sipas Ligjit Nr.10463, datë 22.09.2011 “për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, si dhe të VKM Nr.798, datë 29.9.2010, për miratimin e rregullores “Për administrimin e mbetjeve spitalore” (Rregullorja). Për këtë Operatori Ekonomik duhet të paraqesi:

- katalog të impiantit përkatës, ku përfshihen edhe specifikimet teknike të hollësishme, për secilën procedurë asgjësimi të kërkuar nga Autoriteti ynë Kontraktor. Katalogët do të pranohen vetëm në formë elektronike nëpërmjet Sistemit Elektronik.”

III.3.2. Në nenin 46 pika 1 gërma “a” dhe “b” të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet se: *“Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese”.*

Ndërsa në nenin 53, pika 3 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, përcakohet se: *“Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një oferte të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit...”*

III.3.3. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues për modifikimin e kriterit të përcaktuar nga autoriteti kontraktor në dokumentat standarte të tenderit shtojca 7/2 “Kriteret e veçanta për kualifikim” pika 2.3.4 “kapaciteti teknik dhe profesional”, ku shprehet se” *Edhe kete pike e kundërshtojme te lidhur me kundërshtimin e parashtruar ne (A) me siper, pasi edhe ne kete rast vete AK. duke mos e ndare ne lote proceduren, ka diskriminuar operatoret qe kane licenca dhe impiante per trajtimin e rrymave te mbetjeve te perfshire ne elementet (1), (2) dhe (4) te tabelës se shërbimeve te kerkuara, por qe nuk kane vetem impiant incenerimi per mbetjet ne elementin (3), duke i diskriminuar keta OE”, Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se nuk do të merren në shqyrtim pasi, referuar gjykimit të mësipërm si në pikën III.1.9., Komisioni nuk e gjykon të drejtë pretendimin e ankimuesit lidhur me ndarjen me lote të procedurës, pasi referuar VKM nr. 798, datë 29.09.2010 “Për miratimin e rregullores për administrimin e mbetjeve spitalore” vëren se në Kreun I, pika 1 dhe 2 gërma (k) thuhet se: *“Mbetje të rrezikshme përfshijnë mbeturinat e infektuara, patologjike, shpuese, farmaceutike, toksike, kimike dhe radioaktive dhe tretës të infektuar”.**

Nisur nga sa më sipër si dhe referuar grafikut për ekzekutimin rezulton se mbetjet e përcaktuara nga autoriteti kontraktor për asgjësim në këtë procedurë prokurimi bëjnë pjesë tek mbetjet e rrezikshme të parashikuara në VKM e sa mësipërcituar, dhe ndarja në Lote e procedurës së prokurimit sipas pretendimit të ankimuesit Lot më vetë për mbetjet që nuk përfshihen në kategorinë 18 01 02 dhe Lot më vete për mbetjet që përfshihen në kategorinë 18 01 02, do të komplikonte menaxhimin e kontratave dhe shpërndarjen e përgjegjësisive duke e komplikuar edhe realizimin me sukses të kontratës.

III.4. Lidhur me pretendimin e ankimuesit se: *“... kërkesa që OE të kenë pasur të punësuar në listpagesa gjatë gjithë periudhës janar-tetor 2018 një inxhinier mjedisi, është një kriter që nuk i shërbën qëllimit për realizimin me sukses të kontratës, por krijon efektin e kufizimit për pjesëmarrjen e gjërë të*

operatorëve ekonomikë. Ajo që është e rëndësishme për AK është që OE të ketë në dispozicion për zbatimin e kontratës dhe kjo mund të realizohet, duke u provuar një marrëdhënie e qëndrueshme e OE me inxhinier mjedisi, qoftë në formën e kontratës së punës apo kontratës së shërbimit, për një periudhë të arsyeshme dhe jo domosdoshmërisht përgjatë të gjithë periudhës janar-tetor 2018. Mund të ndodhë që OE të ketë patur në periudha të ndryshme të punësuar ose të angazhuar me kontratë shërbimi inxhinierë mjedisi të ndryshëm, por e rëndësishme për AK është që OE, në momentin e lidhjes eventuale të kontratës, të ketë një inxhinier të tillë, pavarësisht nga historiku i punësimit të këtij inxhinieri në AK...”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.4.1. Në shtojcën 7 “Kriteret e vecanta të kualifikimit”, “Kapaciteti teknik dhe profesional”, pika 2.3.2, rezulton se nga ana e autoritetit kontraktor është parashikuar protësimi i kushtit si më poshtë vijon:

“Kërkohet që ofertuesi të paraqesë një vërtetim për fuqinë punëtore të operatorit ekonomik për periudhën janar-tetor 2018), numri i të cilëve të jetë jo më pak se 3 punonjës të nevojshëm për realizimin e objektit të prokurimit, ndër të cilët njëri nga punonjesit duhet të jetë inxhinier mjedisi, me qëllim realizimin me sukses të këtij Shërbimi.

Për këtë, Operatori Ekonomik duhet të paraqesë:

5 Vërtetim të lëshuar nga Zyra e tatim-taksave së bashku me listëpagesat sipas formularit E-SIG 025, ku te pasqyrohen minimumi tre punonjës;

6 Liste të personelit kryesor të nevojshëm për realizimin e këtij shërbimi.

7 Per inxhinjerin e mjedisit duhet të paraqitet:

c. Kopja e diplomes së Universitetit;

d. Vërtetim nga Tatimet ku të figurojë tek listëpagesat sipas formularit E-SIG 025 si dhe Kontratë Pune e lidhur me inxhinjerin e mjedisit. ”

III.4.2. Në shtojcën 8 “Specifikimet teknike” është parashikuar si më poshtë :

1. Skicimet, parametrat teknik etj: Specifikimi i Materialeve: Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:
2. Mbetjet e rrezikshme spitalore dhe anatomike duhet të asgjësohen në një impiant për inçinerim i cili është i licensuar nga Ministria e Mjedisit për kryerjen e këtij shërbimi, terheqja e mbetjeve do të bëhet sipas nevojave të Autoritetit Kontraktor.
3. Operatori ekonomik duhet të instalojë nga një frigoriferi në ambientet e Spitalit Librazhd e Prrrenjas me kapacitet 200 - 250 L dhe temperature - 18 C për ruajtjen e mbetjeve të rrezikshme spitalore anatomike të lengshme dhe të ngurta deri në momentin e transportimit për në impiantin e asgjësimit. Pas marrjes së mbetjeve operatori do të bëjë dezinfektimin e frigoriferit dhe ambientit përreth , si dhe mirembaje frigoriferin.
4. Të sigurohet dizinfektimi i mirë i frigoriferit dhe ambientit ku është instaluar.
5. Mbetjet duhet të merren nga sipërmarresi pranë Drejtorisë së Spitalit Librazhd dhe Prrrenjas me mjet të posaçëm të sipërmarresit dhe me abalazhimin përkatës në përputhje me standartet e OBSH, për mbetjet e rrezikshme spitalore anatomike të ngurta dhe të lengshme duke respektuar standartin sipas VKM 798, dt.29.09.2010, “ Për administrimin e mbetjeve spitalore “.
6. “Asgjesimi duhet të realizohet në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.798, datë 29.9.2010, për miratimin e rregullores “Për administrimin e mbetjeve spitalore” (Rregullorja), si dhe Udhëzuesit Kombëtar të Administrimit të sigurtë të mbetjeve spitalore.”.

7. Mbetjet do të peshohen ne pranine e perfaqesuesve te te dyja paleve nga një peshore, e cila duhet të disponohet nga Operatori Ekonomik.
8. Qeskat dhe kontenierët duhet të mbulohen nga sipermarsi dhe duhet të jenë me një përdorim. Kontenieret, qeskat që perdoren per grumbullimin e mbetjeve te rrezikshme spitalore që trajtohen ne hidroklaivin e spitalit te sigurohen nga operatori fitues. Kontenieret duhet te jene me kapacitet nga 5 L , 40 L dhe 60 L. Kontenieret dhe qeskat duhet te jene me ngjyre te verdhe dhe logon e firmes fituese. Te gjithë kontenieret që perdoren nga spitali duhet te merren nga firma dhe te behet dezinfektimi i tyre prej saj. Ambalazhi duhet te jete sipas percaktimeve te bera ne VKM 798, dt.29.09.2010 “Per administrimin e mbetjeve spitalore“, si dhe Udhëzuesit kombëtar “Administrimi i Sigurtë i mbetjeve Spitalore”.
9. Autoriteti Kontraktor do të kontrollojë pas hapjes së ofertave impiantin që disponon firma për t’u siguruar për standartin dhe cilësinë e tij.
10. Operatori Ekonomik duhet të pajisi A.K. me sinjalistikë dhe tabela sinjalizuese të cilat tregojnë prezencën e mbetjeve të rrezikshme në ambjentin/ambjentet përkatëse të Autoritetit kontraktor, në bazë të VKM Nr. 798, datë 29.09.2010 dhe Udhëzuesit kombëtar “Administrimi i Sigurtë i mbetjeve Spitalore”.
11. Terheqja e mbetjeve te rrezikshme spitalore do te behet cdo jave ose ne varesi te kerkeses se autoritetit kontraktor.
12. Operatori ekonomik dhe Perfaqesuesit e Spitalit per cdo dorezim mbetjesh spitalore tek operatori per asgjesim do te mbajne “Dokumentin e dorezimit te mbetjeve te Rrezikshme” sipas VKM Nr. 371 date 11.06.2014 “Per miratimin e rregullave per dorezimin e mbetjeve te rrezikshme dhe te dokumentit te dorezimit te tyre”
13. Mbetjet e vendosura në ambalazh do të peshohen në praninë e përfaqësuesve të të dy palëve, hartohet proces verbali për sasinë e peshuar në tre kopje dhe nënshkruhet nga sipërmarrësi dhe përfaqësuesi i autoritetit kontraktor. Dy kopje mbeten në DSHS Librazhd dhe një kopje e merr sipërmarrësit.
14. Pesha e mbeturinave të rrezikshme spitalore do të llogaritet neto duke zbritur peshën e ambalazhit.
15. Tek formulari i transferimit te mbetjeve te rrezikshme spitalore te shenohen dhe kodet perkatese per cdo lloj mbetje:
16. Anatomiket KODI 18 01 02
17. Te mprehtat KODI 18 01 01
18. Te butat, plastiket KODI 18 01 03.”

III.4.3. Në nenin 46 pika 1, gërma “b” e ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet se: “[...] Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese: b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës;

III.4.4. Në nenin 28, pika 5, të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, përcaktohet: “Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti

kontraktor kërkon:

- a) licencat profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose*
- b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla; dhe/ose*
- c) dëshmi për fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose*
- ç) dëshmi për mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.*

III.4.5. Neni 1 i LPP parashikon shprehimish se “*Qëllimi i këtij ligji është: a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik, të kryera nga autoritetet kontraktore; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik si dhe dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.*”

III.4.6. Komisioni i Prokurimit Publik sqaron se kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit ekonomik për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit.

Komisioni vlereson se kriteret e kualifikimit duhet të jenë në përputhje me objektin e prokurimit, natyrën, aftësinë zbatuese, vlerën si dhe përmasat/volumin e kontratës. Në rastin konkret e rëndësishme për autoritetin kontraktor, referuar natyrës së kontratës është realizimi i shërbimit në përputhje me specifikimet teknike dhe sipas kërkesave të autoritetit kontraktor.

Sa më sipër cituar, KPP gjykon se kërkesa e autoritetit kontraktor për një inxhinier mjedisi është në përputhje me objektin, vlerën, rëndësinë si dhe përmasat e kontratës objekt prokurimi. Por KPP vlerëson të drejtë pretendimin e operatorit ekonomik ankimues mbi lirinë kontraktuale dhe ndryshimin e tyre dhe në këtë rast, KPP gjykon se në plotësim të synimit të autoritetit kontraktor, operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të dëshmojnë vijueshmëri të marrdhënieve të punësimit me inxhinierin e sipërcituar, duke dorëzuar dëshmi se për periudhën e kërkuar kanë patur vijueshmëri të stafit teknik (inxhinier) sipas profilit të sipërcituar, megjithëse këto të fundit mund të jenë të ndryshëm nga inxhinieri që disponon të kontraktuar në momentin e dorëzimit të ofertave. Gjithashtu KPP gjykon se është mëse e mjaftueshme që operatori ekonomik ofertues të ketë në stafin e vet inxh.mjedisi me kontratë pune sipas ligjit por njëkohësisht autoriteti kontraktor duhet të lejojë alternativën që operatori ekonomik të kontraktojë me kontratë noteriale për periudhën e zbatimit të kontratës një inxhinier mjedisi dhe për këtë të paraqesë diplomë dhe cv sipas përcaktimeve të autoritetit kontraktor në DST, duke mbajtur në konsideratë edhe vijueshmërinë e kapacitetit të periudhës së kërkuar.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron pjesërisht.

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të pranojë pjesërisht ankesën e operatorit ekonomik “V.A.L.E Recycling” shpk për procedurën e prokurimit “Marrëveshje kuadër” me Nr.REF-95889-11-26-2018, me objekt: “Trajtimi dhe evadimi i mbetjeve të rrezikshme spitalore, në spitalin Librazhd e Prrenjas”, me fond limit 1.200.000 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 07.12.2018 nga autoriteti kontraktor Drejtoria e Sherbimit Spitalor Librazhd.
2. Autoriteti kontraktor të modifikojë dokumentat e tenderit në përputhje me konstatimet e mësipërme të Komisionit të Prokurimit Publik.
3. Autoriteti kontraktor, brenda 10 ditëve, të verë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
4. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “V.A.L.E Recycling” sh.p.k.
5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

Nr. 1883 Protokoli

Datë 14.12.2018

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Enkeleda Bega

Anëtar
Vilma Zhupaj

Anëtar
Lindita Skeja

Anëtar
Merita Zeqaj

Kryetar
Evis Shurdha